




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për Transparencën në Komuna, neni 7 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, dhe nenit 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën: 29.07.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### **Për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023**

#### **Neni 1**

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.

#### **Neni 2**

Propozimi në diskutim publik i projekt planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023 do të jepet në diskutim publik deri më:30.08.2022. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së dëgjimit publik ne zyrën e sekretarisë së Kuvendit Komunal të Vitisë ndërtesa e komunës (ish tatimi në pronë), zyra nr. 2 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën [fatlum.demiri@rks-gov.net](mailto:fatlum.demiri@rks-gov.net), dokumenti gjendet në fep faqen e komunës së Vitisë, [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti).

#### **Neni 3**

Debati publik do të mbahet me datën 05.09.2022, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

#### **Neni 4**

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë. Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive në propozim planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.

#### **Neni 5**

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të tij, propozimet i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

#### **Neni 6**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Zyra e Sekretarisë së Kuvendit.

#### **Neni 7**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së sekretaris,
2. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI  
Bekim Azizi

